



Parimet për Ballafaqimin me të Kaluarën

**Parimi: Barazia, gjithëpërfshirja dhe pajtimi
duhet të promovohen nga të gjithë**

Studim i rasteve



Parimet për ballafaqimin me të kaluarën

Parimet për ballafaqimin me të kaluarën është një iniciativë qytetare, e promovuar nga koalicioni jo formal i përbërë nga 5 organizata dhe një eksperte: Fondi për të Drejtën Humanitare në Kosovë, Qendra Kosovare për Rehabilitimin të Mbijetuarve të Torturës, Integra, Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, BIRN dhe Nora Ahmetaj. Grupi ka ndërmarrë një iniciativë të përbashkët për të hartuar dhe aprovuar një grup parimesh të cilat do të informojnë dhe udhëzojnë akterët politik dhe publik se si do të trajtojnë viktimat, të mbijetuarit/at, të kaluarën e dhimbshme dhe narrativat historike. Iniciativa ka për qëllim që të parandalojë diskursin dhe veprimet e dëmshme në lidhje me trashëgiminë e konfliktit dhe do të shërbejë si dokument referues, ku secili/a që shkel parimet e tij/saj duhet të mbahet moralisht përgjegjës. Andaj, qëllimi është që të aplikohen këto parime dhe të respektohen vlerat dhe ndjenjat që ato mishërojnë, në mënyrë që të sigurohet që viktimat dhe të mbijetuarit të mos dëmtohen dhe se veprimet që ndërlihen me ballafaqimin e të kaluarës do të kontribuojnë në procesin e pajtimit.¹ Tani kur parimet janë zhvilluar e janë organizuar, gjithashtu edhe janë të shpjeguara mirë, ka një rëndësi kryesore që të prezantohen tek një publik i gjerë dhe të promovohen në mënyrë korrekte. Ne besojmë se një nga mënyrat për të bërë njerëzit të kuptojnë për rëndësinë e parimeve është të tregohet për dëmet, pasojat dhe dhimbjen, të cilat mund të shkaktohen në situatat kur parimet janë të shkelura. Prandaj koalicioni do të publikojë disa analiza të cilat do të përpilohen nga ana e Fondit për të Drejtën Humanitare Kosovë (FDHK) dhe ne do të përqipemi që të sjellim shembuj konkret nga e kaluara ku parimet janë përdorur në mënyrë të duhur apo edhe janë keqpërdorur. Një nga këto parime është “Barazia, gjithëpërfshirja dhe pajtimi duhet të promovohen nga të gjithë”.

Barazia, gjithëpërfshirja dhe pajtimi duhet të promovohen nga të gjithë

Përfshirja e viktimave dhe të mbijetuarve/ave shpesh bazohet në gjininë, moshën, përkatësinë etnike ose racën. Për të arritur pajtimin, shoqëria në Kosovë duhet të krijojë një qëndrim të përbashkët që individët të tregojnë njohje, respekt dhe pranim të ndërsjellë, si dhe ndjeshmëri ndaj nevojave dhe interesave të palës tjetër.

Prandaj në mënyrë që të kuptohet qartësisht thelbi i parimit të cilin po e promovojmë në këtë analizë, ne do të shpjegojmë se mbi cilën bazë garantohen të drejtat e promovuara në parim dhe gjithashtu të studiojmë disa raste kyçe, të cilat e kanë shkelur parimin e lartcekur.

Hyrje

United Nations Development Programme (UNDP) në bashkëpunim me disa partnerë të tjerë në vitin 2017 botoi një dokument, në të cilin u tha se “Kosova do të promovojë dhe respektojë plotësisht një proces të pajtimit ndërmjet të gjitha komuniteteve të saj dhe anëtarëve të tyre. Ajo do të vendosë një qasje gjithëpërfshirëse dhe të ndjeshme gjinore për trajtimin me të kaluarën e saj, e cila do të përfshijë një gamë të gjerë të iniciativave të drejtësisë tranzicionale.”² Ky detyrim i përfshirë në këtë botim, ishte marrë nga Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të vitit 2007, ku ato së bashku, ishin inkuorporuar në Kushtetutën e Kosovës pas pavarësisë në vitin 2008.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton dhe promovon të drejtat dhe liritë e qytetarëve të saj në përgjithësi, por edhe të komuniteteve të tjera jo shumicë në veçanti, pa marrë parasysh dallimet të cilat ato i kanë. Sipas kapitullit të dytë të saj, i cili normon të drejtat dhe liritë themelore të qytetarëve të Kosovës thuhet se të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë apo dallimeve të tjera dhe se dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.³ Këto të drejta janë gjithashtu të garantuara edhe me një numër të madh të marrëveshjeve e konventave ndërkombëtare, ndër tjera edhe me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut⁴ të vitit 1948 dhe me Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike⁵ të vitit 1976.

¹ Principi ALB (vibr-ks.org)

² UNDP, “Dealing with the Past and Reconciliation in Kosovo: A Summary of Institutions and Initiatives a Working Document”, 2017, u citua “Propozimi Gjithëpërfshirës për zgjidhjen e Statusit të Kosovës”, artikulli 2.5.

³ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 21-24, faqe 6-7, [Microsoft Word - Kushtetuta e Republikës së Kosovës.doc \(rks-gov.net\)](#)

⁴ Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, 1948,

<https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/regulations/03albanian/Ahri/AUniversalDeclarationHumanRightsfinal.pdf>

⁵ Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, 1976, <https://hrrp.eu/alb/docs/CCPR-a.pdf>



Duke qenë se këto të drejta janë të garantuara përmes legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar, nuk duhet të tolerohet trajtimi jo i barabartë dhe i pa dinjitetshëm ndaj cilës do kategori shoqërore, pavarësisht elementeve dalluese në mes tyre. Prandaj në vazhdim kemi marrë disa raste studimi, të cilat dëshmojnë pasojat që ka trajtimi jo i barabartë i grupeve të ndryshme shoqërore. Barazia, respektimi dhe gjithëpërfshirja e qytetarëve, e posaçërisht e viktimave e të mbijetuarve të luftës së fundit në Kosovë, përbëjnë bazën për pajtim dhe themelin e një shoqërie demokratike.

Mospërfshirja e emrit të vajzës rome në pllakën përkujtimore në Mitrovicë

Më 13 maj të vitit 1999, në tregun e gjelbër të Mitrovicës kishte shpërthyer një bombë, ku sipas të dhënave të FDHK, mbetën të vdekur 7 persona, prej tyre 3 femra e 4 meshkuj dhe të plagosur dhjetëra të tjerë. Ndërsa në përvjetorin e 21-të të këtij incidenti, më datë 13 maj 2020, u ngrit pllaka e re përkujtimore, e cila zëvendësonte pllakën e vjetër, në kujtim të viktimave dhe të plagosurve të atij sulmi. Në njëren pjesë të pllakës ishte shkruar narrativi i incidentit, me tekst “Këtu me 13 mars 1999, në orën 14:20 min, granata e shkrepur nga dora barbare e ushtrisë dhe policisë serbe u mori jetën 6 vetave dhe i plagosi 128 të tjerë.”⁶ Ndërsa në pjesën tjetër të pllakës, ishin gdhendur emrat e gjashtë viktimave shqiptare, por jo edhe emri i Elizabeta Hasanit, vajzë e mitur e komunitetit rom.⁷

Mos përfshirja e emrit të saj nga Komuna e Mitrovicës shkaktoi reagime të shumta, por nga to më të bujshmet kishin qenë reagimet e dy deputetëve të Kuvendit të Kosovës, Veton Berisha e Albert Kinolli, përfaqësues të komuniteteve RAE, të cilët kishin kërkuar përfshirjen e vajzës në pllakën përkujtimore të ngritur në Mitrovicën e Jugut. Albert Kinolli pas reagimit të tij, kishte mbajtur një takim me kryetarin e Komunës së Mitrovicës Jugore Agim Bahtiri, nga i cili ishte njoftuar se ky lëshim kishte ndodhur pa qëllim dhe në mungesë të informacioneve.⁸

Lidhur me këtë mospërfshirje kishte reagu edhe publicisti e aktivisti i shoqërisë civile Shkelzen Gashi, i cili kishte thënë se gjatë hulumtimeve të tij në lidhje me vrasjet të cilat kishin ndodhur në tregun e gjelbër të Mitrovicës, kishte hasur në mos përputhje të të dhënave. Ai po ashtu tha se pothuajse çdo lajm në shtyp në atë kohë raportonte se një nga të vrarët në atë masakër, ishte një fëmijë pesë vjeçar.⁹

Nënkryetari i Komunës së Mitrovicës Faruk Mujka ishte përgjigjur ndaj reagimit të Shkelzen Gashit dhe për mospërfshirjen e vajzës ishte prononcuar për Kallxo.com, se në fakt të dhënat në lidhje me incidentin, përkatësisht se emrat e vendosur në pllakë i kanë marrë nga Këshilli për të Drejtat e Njeriut dhe Zyra për Mirëqenie Sociale. E sipas tij edhe në fjalorin enciklopedik të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës figuronin vetëm gjashtë emra të viktimave. Për këtë ai ishte zotuar se pllakës do t'i shtohet edhe emri i Elizabeta Hasanit dhe kishte njoftuar se në fakt Komuna e Mitrovicës në prill të vitit 2019, kishte bërë thirrje publike nëpërmjet web faqes zyrtare të saj, drejtuar të gjithë atyre që kanë njohuri për viktimat dhe të lënduarit e ngjarjes, që të lajmërohen në komunë.¹⁰ Kjo ishte bërë me qëllim që komuna të mblidhte të dhënat e nevojshme në lidhje me të gjitha viktimat që kanë humbur jetën në tregun e gjelbër të Mitrovicës. Mirëpo një gjë e tillë nuk e arsyeton faktin se një viktimë ishte lënë pa u përmendur në pllakë, e aq më tepër kur e njëjta është ngritur me iniciativën e institucioneve shtetërore, të cilët ishin dashur që të kenë informacione të verifikuara. Rastin e bën edhe më të ndjeshëm fakti se viktimat kishte qenë pjesë e një komuniteti pakicë.

Pas më shumë se dy dekadave të përfundimit të luftës, institucionet shtetërore nuk duhet të japin arsytetime se nuk kanë pasur informacione të mjaftueshme, duke qenë se ata e kanë për detyrë që të verifikojnë dhe të dokumentojnë ngjarjet e së kaluarës. Mungesa e informacioneve që ka për pasojë mos përfshirjen e viktimave për shkak të etnisë së tyre, nuk i kontribuon pajtimin në mes të etnive në Kosovë.

Mospërfshirja e emrit të saj në pllakën përkujtimore e kishte prekur më së shumti babain e Elizabetës, Rrahim Hasanin. Ai në një intervistë për Radio Evropa e Lirë kishte shprehur dhimbjen e tij, duke thënë se, “më dhemb zemra, beso. Duhet të dihet kush është duke pushuar aty... Kur e ka emrin aty, edhe mua zemra më pushon, më vjen më lehtë. A kështu po më duket keq, shumë keq.”¹¹

Si rezultat i reagimeve të shumta dhe premtimit të komunës që emri i viktimës t'i shtohet pllakës përkujtimore, më 17 gusht

⁶ Klan Kosova, [Klan Kosova](http://KlanKosova.com), [Komuna e Mitrovicës sgaron mospërfshirjen e emrit të vogëlshes Elizabeta Hasanit në pllakën përkujtimore](http://KlanKosova.com) (klankosova.tv)

⁷ Kallxo.com, 02.08.2020, [Nënkryetari i Mitrovicës flet rreth mungesës së emrit të romes 5-vjeçare në pllakën përkujtimore të masakrës në treg](http://Kallxo.com) (kallxo.com)

⁸ Telegrafi.com, 07.08.2020, [Deputetët kërkojnë që emri i Elizabeta Hasanit të vendoset sa më shpejt në pllakën përkujtimore](http://Telegrafi.com) - Telegrafi

⁹ Balkan Insight, 04.08.2020, [Si s'u përfshi emri i një vajze rome në pllakën përkujtimore të një masakre në Kosovë](http://BalkanInsight.com) | Balkan Insight

¹⁰ Kallxo.com, 02.08.2020, <https://kallxo.com/lajm/nenkryetari-i-mitrovices-flet-rreth-mungeses-se-emrit-te-romes-5-vjecare-ne-pllaken-perkujtimore-te-masakres-ne-treg/>

¹¹ Radio Evropa e Lirë, 06.08.2020, [Babai i Elizabetës kërkon kujtimin e saj](http://RadioEvropa.org) (evropaelire.org)



të vitit 2020, Komuna e Mitrovicës e kishte vendosur emrin e Elizabeta Hasanit në pllakë. Kryetari i Komunës Agim Bahtiri së bashku me nënkryetarin Faruk Mujka dhe ish deputetin Albert Kinolli, zbuluan emrin e saj në pllakën përkujtimore.¹² Ky rast dëshmon se ende sot pjesëtarë të etnive të ndryshme nuk trajtohen në mënyrë të barabartë.

Në vazhdim do të shtjellojmë edhe dy raste të tjera të ngjashme, të cilat kanë ndodhur së fundi dhe të cilat na bëjnë të ditur se ne si shoqëri duhet të krijojmë një qëndrim të përbashkët në mënyrë që të gjithë individët të tregojnë njohje, respekt dhe pranim të ndërsjellë ndaj nevojave dhe interesave të palës tjetër.

Përfshirja e viktimave Serbe në pllakën përkujtimore në Lluzhan të Podujevës

Më 1 maj të vitit 1999, NATO kishte goditur një autobus i cili po kalonte mbi urë në fshatin Lluzhan të Komunës së Podujevës. Në këtë incident sipas të dhënave të FDHK, kishin humbur jetën gjithsej 44 persona, 31 nga të cilët kishin qenë civilë shqiptarë dhe 13 të tjerë serb, prej të cilëve 7 ishin civilë.

Për incidentin ishte deklaruar koloneli i NATO-s Konard Freytag, sipas të cilit NATO e kishte marrë përgjegjësinë për sulmin, me arsyetimin se autobusi i cili po në atë moment po kalonte mbi urë, nuk ishte parë nga piloti, pasi që vëmendja e tij kishte qenë e përqendruar në shënjestrën e tij, e që ishte ura.¹³ Ngjarja tragjike e Lluzhanit mori vëmendjen e mediave më prestigjioze botërore, duke përfshirë edhe CNN e New York Times, në të cilat padyshim u raportua edhe për numrin e viktimave të cilët humbën jetën në këtë incident.

Në përvjetorin e 22-të të incidentit tragjik, përkatësisht më 1 maj 2021, në vendin e ngjarjes u përrua një pllakë përkujtimore, në të cilën ishin gravuar emrat e 31 viktimave të nacionalitetit shqiptarë. Ndërsa numri rendor 32, në vend të emrit të ndonjë viktime, përmbante tri pika.

Gjatë përrimit të kësaj pllake, kryetari i komunës së Podujevës Shpejtim Bulliqi, kishte thënë se ky memorial u ndërtua nga Komuna e Podujevës, por me iniciativë të përbashkët me familjet e viktimave. Ndërsa në llogarinë e tij në rrjetin social Facebook, i njëjti e kishte postuar fjalimin, të cilin edhe e kishte mbajtur gjatë asaj dite, ku thoshte se “bashkë me kolegë të ekzekutivit, anëtarë të familjeve të viktimave dhe qytetarë kemi shpalosur pllakën përkujtimore me të gjithë emrat e viktimave që kanë pësuar nga kjo tragjedi. Sot janë bërë 22 vjet, kur në urën e Lluzhanit u vranë 31 shqiptarë të pafajshëm.”¹⁴ Pra, ai në fjalimin e tij kishte thënë se në pllakë ishin emrat e të gjitha viktimave.

Për këtë mospërfshirje ka reaguar FDHK, duke kërkuar paraqitjen e drejtë të ngjarjes dhe përfshirjen e të gjitha viktimave të cilat kanë humbur jetën në atë incident. Ky reagim ishte mbështetur edhe nga koalicioni jo-formal i organizatave jo-qeveritare dhe gjithashtu është transmetuar nga një numër i madh i mediave kosovare.¹⁵

Televizioni Klan Kosova ndërlidhur me reagimin e bërë ndaj mos përfshirjes së viktimave serbe, gjatë edicionit të tyre në Info Magazinë më datë 5 maj, thanë se kishin provuar që të sigurojnë informacione më të hollësishme nga Komuna e Podujevës. Kjo Komunë përmes një përgjigjeje zyrtare për Klan Kosovën ishte arsyetuar se nuk kanë pasur informacione për viktimat e tjera. Gjithashtu është cekur se ata kanë kërkuar ndihmë së bashku me banorët e kësaj zone dhe me familjarët e viktimave, mirëpo nuk kanë arritur që të gjejnë emrat e viktimave të tjera. Kjo ishte arsyeja që numri 32 në pllakën përkujtimore është me tri pika, që nënkupton që ka edhe viktima të tjera, për emrat e të cilëve komuna nuk kishte informacione.¹⁶

Ndërsa në një përgjigje zyrtare të cilën e ka dhënë zëdhënësi i Komunës së Podujevës, Fatri Zhitia për ATV-në, ai tha se në memorial janë të përfshirë të gjithë emrat e të vdekurve të bazuara në raportet të cilat janë të regjistruara në Komunë dhe se numri 32 në memorial tregon viktimat që nuk janë të regjistruara.¹⁷

Prandaj nga deklaratimet e mësipërme të dhëna nga vet komuna e Podujevës, kuptojmë që komuna kishte pasur informacione se në këtë incident kishin humbur jetën edhe viktima të tjera, duke pasur parasysht edhe vendosjen e pikave në numrin 32 të listuar në pllakën përkujtimore. Atëherë ata është dashur të bëjnë hulumtime shtesë në mënyrë që të sigurojnë informacionet e sakta në lidhje me numrin dhe nacionalitetin e viktimave. Me pak përkushtim do të mund të kishin qasje në raportimet e

¹² Komuna e Mitrovicës, 17.08.2020, » Komuna e Mitrovicës vendos emrin e vogëlshes së ndërës Elizabeta Hasani në pllakën përkujtimore kushtuar masakrës së tregut (rks-gov.net)

¹³ Human Rights Watch, “Kosovo: Civilian Deaths in the NATO Air Campaign”, 1 Shkurt 2000, pika 41, [Civilian Deaths in the NATO Air Campaign - Appendix A \(hrw.org\)](#)

¹⁴ [Shpejtim Bulliqi - Posts | Facebook](#)

¹⁵ Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë, Reagim, 05.05.2021, <https://www.hlc-kosovo.org/sq/media/komunikata-per-media/78/reagim-kerkohet-perfshirja-e-te-gjitha-viktimave-ne-pllaken-perkujtimore-ne-lluzhanluzane>

¹⁶ Video Online, Klan Kosova, Info Magazinë, 05.05.2021, [Info Magazine Archives - Klan Kosova](#)

¹⁷ Video Online, ATV Live, Lapidari në Lluzhan, 05.05.2021, [FDHK kritikon Komunën e Podujevës për mospërfshirje të viktimave serbe në lapidar - ATV LIVE](#)



shumta në lidhje me incidentin, duke përfshirë këtu edhe raportimet të cilat ishin bërë nga mediat ndërkombëtare. Përveç Klan Kosovës, edhe Radio Evropa e Lirë i ishte referuar reagimit dhe kishte realizuar një intervistë me prindërit e dy prej viktimave serbe të cilët nuk ishin përmendur në pllakën përkujtimore. Kjo radio kishte paraqitur zhgënjimin e familjarëve në lidhje me mos përfshirjen e fëmijëve të tyre në atë pllakë. Njëri nga ta u kishte thënë se "nuk ka rëndësi nëse ai është një serb, shqiptarë apo romë, emrat e të gjitha viktimave duhet të kishin qenë në atë pllakë përkujtimore. Unë do të doja që emrat e fëmijëve të mi të ishin në atë pllakë." Të njëjtin mendim e ndanin edhe familjarët e viktimave, emrat e të cilëve gjenden në pllakën përkujtimore. Një qytetarë shqiptarë nga Podujeva, i cili gjithashtu ishte i intervistuari i Radio Evropës së Lirë, e i cili kishte humbur xhaxhain dhe gjyshin e tij në atë ngjarje, në të njëjtën formë kishte shprehur zhgënjimin e tij në lidhje me mospërfshirjen e viktimave serbe në atë pllakë. Ai ndër tjerash ishte deklaruar se "politika duhet të lihet mënjanë."¹⁸

Përrjashtimi i viktimave nga pllakat përkujtimore është i papranueshëm, pasi që viktimat të cilat e kanë humbur jetën në kohë dhe rrethana të njëjta, nuk mund të ndahen mbi baza etnike e as mbi baza të tjera.

Denigrimi i viktimave Serbe gjatë debatit televiziv

Më 15 qershor të vitit 2021, në televizionin Klan Kosova, u mbajt një debat në lidhje me dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, ku tema ishte takimi i delegacionit kosovar dhe atij serb në Bruksel. Në këtë takim Kryeministri i Kosovës Albin Kurti kishte adresuar katër propozime ndaj delegacionit serb në krye të të cilit ishte Presidenti Aleksandar Vuçiq, ku një prej propozimeve kishte të bënte me çështjen e të zhdukurve.

Në këtë debat ishin të ftuar 2 deputetë të Kuvendit të Kosovës nga radhët e lëvizjes Vetëvendosje, Artan Abrashi dhe Arbëreshë Kryeziu Hyseni, si dhe 3 opinionistët e rregullt të emisionit Rubikon, Rahman Paçarizi, Jehona Lushaku Sadriu dhe Shkelzen Gashi. Gjatë këtij debati ndër tjerash u diskutua edhe për propozimin e katërt lidhur me çështjen e të zhdukurve. Në pyetjet e parashtruara nga udhëheqësi i emisionit Adriatik Kelmendi, drejtuar Arbëresha Kryeziu Hysenit, ajo u deklarua se çështja e të zhdukurve është jashtëzakonisht e rëndësishme dhe nuk mund të presë më shumë. Në lidhje me kërkesën e palës serbe për zbulimin e fatit të të zhdukurve serbë në Kosovë, deputetja shtoi se ajo nuk besonte që mund të bëheshin krahasime në mes të kësaj kërkesë dhe të pagjeturve shqiptarë. Kjo për shkak se sipas saj "ne e dimë shumë mirë që serbët kanë kryer gjenocid ndaj popullit shqiptarë. Janë ata që duhet të japin përgjegjësi për të pagjeturit shqiptarë."¹⁹ Ndërlidhur me këtë deklaram të saj, Adriatik Kelmendi kishte ndërhyrë duke thënë se familjarët e të zhdukurve njëlloj kërkojnë zbulimin e fatit të familjarëve të tyre, pavarësisht etnisë dhe fajit që i përshkruhet njëres palë ose tjetres. Sipas tij ata janë të zhdukur, si për nënën serbe ashtu edhe për nënë shqiptare. Ai gjithashtu kishte kërkuar nga deputetja që të fliste lidhur me kërkesën e parashtruar nga pala serbe sa i përket çështjes së të zhdukurve dhe jo për fajësinë e shtetit serb.

Mirëpo ajo megjithatë vazhdoi të fliste për përgjegjësinë të cilën e kishte Serbia, duke thënë se asnjëherë nuk mundemi ta barazojmë fajin që e ka Serbia ndaj neve, me kërkesën e saj ndaj Kosovës. Deputetja e pranonte faktin se edhe ata ishin të zhdukur, por shtoi se "nuk mund asnjëherë të barazohet çështja e të pagjeturve që i kërkon Serbia, me të pagjeturit tanë. Çështja e të pagjeturve të popullit shqiptarë është definitivisht çështje që duhet të trajtohet me seriozitet të jashtëzakonshëm dhe me prioritet shumë të madh, edhe pastaj kur t'i vije radha le të flasin edhe për të pagjeturit serbë."²⁰

Në këtë deklaratë Arbëreshë Kryeziu Hyseni pohoi se çështja e të zhdukurve shqiptarë do të duhet të kishte prioritet karshi çështjes së të zhdukurve serbë. Qartazi ajo arriti që të shprehë ndarësi në mes të etnive dhe t'i trajtojë ata jo të barabartë.

Mbi të gjitha, deputetja denigroi të zhdukurit serb duke relativizuar numrin e tyre. Për sa i përket numrit të serbëve të zhdukur ajo i referohet: "nuk mundemi me krahasuar dëmin që ata i kanë shkaktuar popullit shqiptarë, me këto kërkesa që ata i kanë, le të themi për ata pak persona të humbur prej luftës së fundit."²¹

Por në fakt, numri i të zhdukurve serbë nuk është i vogël ashtu siç u deklarua deputetja. Nëse bazohemi në të dhënat e përditësuara në databazën e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq²² të vitin 2020, aty figurojnë 1645 persona të zhdukur, prej të cilëve mbi 400 të nacionalitetit serb. Kjo listë e personave të zhdukur është listë mbi të cilën bazohet edhe Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur. Andaj pavarësisht numrit dhe etnisë së personave që ende sot rezultojnë të zhdukur nga lufta e fundit në Kosovë, zbulimi i fatit të tyre duhet gjithmonë të trajtohet me prioritet dhe rëndësi të veçantë.

¹⁸ Radio Slobodna Evropa, 7 maj 2021, [Spomen ploča koja deli žrtve na Kosovu: Tri tačke za 'ostale' \(slobodnaevropa.org\)](https://www.slobodnaevropa.org)

¹⁹ Video online, Rubikon me Adriatik Kelmendi, 15.06.2021, [RUBIKON - Dialogu i Albin Kurtit - 15.06.2021 - Klan Kosova - YouTube](https://www.rubikon.org.mk)

²⁰ Po aty.

²¹ Po aty.

²² [International Committee of the Red Cross \(icrc.org\)](https://www.icrc.org)



Është për t'u brengosur që një përfaqësuese e qytetarëve të Kosovës të ketë një qasje të tillë, që përjashton dhe denigron viktimat e një etnie të caktuar, duke pasur parasysh që kjo deputete mund të ndikojë në hartimin e politikave dhe legjislacionit në lidhje me trajtimin e së kaluarës.

Në lidhje me deklaratat shqetësuese të deputetes në debatin televiziv, më 17 qershor 2021 ka reaguar Koalicioni jo-formal për Ballafaqimin me të Kaluarën. Ky koalicion ka kërkuar që institucionet relevante në Kosovë të dënojnë gjuhën denigruese të përdorur nga ajo. Kjo për arsye se deklarimi i deputetes bie ndesh me dispozitat kushtetuese, me parimet për ballafaqimin me të kaluarën si dhe me parimet e drejtësisë tranzicionale. Në të njëjtën kohë, është kërkuar që të gjitha institucionet shtetërore por edhe e mbarë shoqëria të kenë një qasje të barabartë në trajtimin e viktimave të luftës, pasi që vetëm kështu do të mund të arrijmë të krijojmë një shoqëri paqësore dhe të barabartë.²³

Rekomandime

Meqenëse trashëgimia e luftës është një çështje shumë e ndjeshme ajo duhet të trajtohet në mënyrë të kujdesshëm duke evituar mundësitë që të fyhen, denigrohen dhe përjashtohen viktimat. Prandaj, në mënyrë që të ketë sa më pak raste të tilla në të ardhmen, në rend të parë rekomandojmë që “Parimet për Ballafaqimin me të Kaluarën”,²⁴ të respektohen dhe adaptohen nga të gjithë akterët politik dhe publik, e të cilët merren me trajtimin e së kaluarës.

Memorializimi i së kaluarës dhe komemorimi i viktimave, duke përfshirë edhe ngritjen e memorialëve në nderim të tyre, duhet të bëhet në mënyrë gjithëpërfshirëse, jo diskriminuese dhe pa përjashtime. Të gjitha institucionet, ato qendrore dhe lokale, duhen të jenë të kujdesshëm që kur të ndërtojnë një pllakë përkujtimore apo memorial, e ku përmenden emrat e viktimave, të sigurohen që në atë pllakë përkujtimore apo memorial janë shënuar emrat e të gjitha viktimave, pa marrë parasysh gjininë, statusin, prejardhjen etnike apo racore.

Të gjithë personat të cilët flasin në publik në lidhje me viktimat e luftës, e sidomos përfaqësuesit e partive dhe institucioneve të vendit, duhet të bazohen në fakte të vërtetuara dhe mos të përmendin shifra të viktimave në mënyrë arbitrare. Gjithashtu, në fjalimet publike përfaqësuesit e institucioneve nuk duhet të nënçmojnë një grup të viktimave dhe të promovojnë pabarazinë për viktimat. Një diskurs i tillë do të fyejë viktimat, do e rritë mosbesimin ndaj institucioneve dhe në periudhë afatgjate do e pengojë arritjen e paktimit.

Ky projekt implementohet me mbështetjen e Ambasadës Zvicerane në Kosovë dhe Ambasadës Britanike në Prishtinë përmes Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë, dhe përmbajtja e përfshirë në këtë analizë nuk pasqyron pikëpamjet e tyre.

²³ Facebook Page, Dealing with the past Principles, <https://www.facebook.com/dwpkosovo/posts/205400061465039>

²⁴ Principi ALB (vibr-ks.org)

 [@dwpkosovo](#)

 [@dwpkosovo](#)

 [@dwpkosovo](#)

 [dwpkosovo](#)